



Programi Politik i
Kandidates për Kryetare të
Partisë Demokratike

EDIT HARXHI

PËR PD

Vizion i Ri Mbi Idealet e Vitit 1990

Maj 2021

Hyrje – Partia e shpresës, meritokracisë dhe antikomunizmit

Ringritja e Partisë Demokratike do të shënojë edhe fundin e tranzicionit shqiptar.

Ne do të nisim RINGRITJEN SHQIPTARE.

Përgjatë rrugëtimit 30-vjeçar në tranzicionin politik, kulturor dhe ekonomik të vendit tonë, në momentet më të vështira, përballë rrethanave kombshkatërruese dhe sfidave nga më dekurajueset, shoqëria shqiptare përherë ka kthyer vështrimin tërë shpresë drejt Partisë Demokratike.

Rrethanat historike të fillimviteve nëntëdhjetë e bënë **Partinë Demokratike që të identifikohet pazgjidhshmërisht me vlerat, parimet e djathta dhe euro-atlantike. Bashkëpunimi i ngushtë dhe i vazhdueshëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian** u vlerësua si rrugëzgjdhja e vetme për të ndryshuar për mirë vendin tonë. Një pjesë e konsiderueshme e shoqërisë e pa grupimin tonë politik si mjetin me të cilin mund të largohet zgjedha komuniste dhe diktatura që kishte shtypur vendin për gati gjysmë shekulli.

Kjo parti politike mundësoi zgjimin në sytë e çdo shqiptari të:

- dëshirës për ndryshim,
- shpresës se mund të rikthehej liria në një shoqëri të pushtuar,
- synimit për rivendosjen e drejtësisë, pas 45 viteve padrejtësi dhe rrënim
- **qëllimit për të krijuar një shtet perëndimor, me vlera dhe parime euroatlantike, me meritokraci, institucione të forta e të besueshme, zgjedhje të lira dhe të ndershme, ekonomi tregu, forcim të familjes dhe të individit.**

Partia Demokratike ka ditur, që në momente të caktuara përgjatë tri dekadave të fundit, të ngrihet në lartësinë e besimit të qytetarëve shqiptarë dhe t'i sjellë ata më afër Bashkimit Evropian, duke forcuar paralelisht marrëdhënien e ngushtë me aleatin tonë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Partia Demokratike lindi si shtëpia e madhe e individëve që duan lirinë dhe përqafojnë të drejtat natyrale të njeriut për t'u shprehur, për të ndërtuar një familje me të ardhme në vendin e vet, për të punuar, për të pasur pronën e vet, për të krijuar një jetë më të mirë dhe për të pasur mundësi të barabarta. Ky është dhe duhet të jetë misioni i Partisë Demokratike. Vetëm duke siguruar këto të drejta të patjetërsueshme të individit, kjo Parti bëhet shtëpia e madhe e të përndjekurve politikë, e pronarëve të ligjshëm, e mbështetësve të ekonomisë së tregut, e atyre që duan meritokracinë, e pasardhësve, si të periudhës së monarkisë dhe atyre të Ballit Kombëtar, si dhe të gjithkujt që refuzon diktatin e komunizmit, autoritarizmit dhe rrënimin që sjell socializmi.

Partia Demokratike u krijua dhe u rrit si përfaqësuese e interesave të grupeve të ndryshme në shoqëri, të cilat bashkohen në disa vlera dhe parime, që kanë treguar se mund t'i sjellin Shqipërisë ndryshimin që meriton. Secili prej këtyre grupeve të sipërpërmendur të qendrës së djathtë përbën një potencial të jashtëzakonshëm dhe një vlerë të shtuar të pashembullt, me anë të së cilave Partia Demokratike kthehet në mënyrë të sigurt dhe të shpejtë në forcë qeverisëse me mundësinë për t'i bërë mirë vendit tonë, siç ka ndodhur në të kaluarën.

Por sot, Partia e shpresës, lirisë dhe meritokracisë ndodhet në një udhëkryq që do të përcaktojë fatin e saj. A do e lejojmë ne shtëpinë tonë politike dhe investimin tonë 30-vjeçar të shkojë drejt shpërbërjes dhe harresës apo do ta ringrejtmë, forcojmë dhe bashkojmë drejt idealeve që frymëzuan dhe ringjallën një komb të tërë në vitin e shpresës 1990?

Partia Demokratike ka humbur qartësinë e vet ideologjike, ka harruar misionin e saj, ka braktisur gati çdo ideal themelues dhe ka larguar grupimet shoqërore që qëndrojnë në themel të saj. Në mënyrë që Partia jonë të arrijë të frymëzojë sërish shumicën e popullsisë, dhe të kthehet në forcë qeverisëse duhet t'i adresojë këto probleme.

Duhet të kuptojmë që nuk është vetëm anëtarësia e Partisë sonë që pret prej nesh. Sytë e çdo qytetari shqiptar që kërkon ndryshimin e vendit, janë të kthyer tek ne. Presin veç një sinjal që Partia Demokratike të kthehet sërish shtëpia e tyre.

- lirisë,
- intelektualëve, profesionistëve, shtresës së mesme, akademikëve
- të përndjekurve të regjimit të shkuar dhe atij të sotëm,
- pronarëve të ligjshëm, të emërtuar tinëzisht ish-pronarë,
- sipërmarrësve,
- punëtorëve,
- prodhuesve të këtij vendi.

Sot kemi mundësinë që, njësoj si në vitin 1990, 1992 dhe 2005, të ngrihemi në lartësinë që kërkojnë qytetarët shqiptarë dhe sfidat e mëdha të së ardhmes së kombit tonë, në çdo trevë shqiptari. Partia Demokratike, duke adresuar problemet ideologjike dhe strukturore që ka, shumë shpejt do të rikthehet në forcë qeverisëse e vetme. Për të arritur këtë duhet patjetër që:

- Partia Demokratike **t'i kthehet anëtarëve të saj dhe t'i shërbejë interesit qytetar;**
- Të vendosen **debati dhe konkurrenca e lirë** brenda Partisë;
- T'i jepet fund emërimeve nga ana e Kryetarit apo Kryesisë së Partisë;
- Të mundësohet **decentralizimi dhe autonomia e degëve të Partisë** nëpër qarqet e vendit.
- Të ndodhë **bashkimi i Partisë** rreth vlerave dhe parimeve të djathta dhe **rikthimi i çdo personalitetit e kontribuesi**, që prej themelimit të Partisë dhe atyre që e konsiderojnë Partinë Demokratike shtëpinë e tyre. Kështu, do të arrijmë një **ringritje, bashkim dhe forcim të së djathtës** shqiptare;
- Te **pranohen të rinjtë shqiptarë dhe kontributi, idetë dhe vizioni i tyre** të jenë pjesë e programit qeverisës. Forumi Rinor dhe Lidhja Demokratike e Gruas duhet të ketë të drejta si gjithë anëtarësia e Partisë dhe anëtarët e FRDP-së dhe LDGSH-së të jenë anëtarë partie. Në kohën e inteligjencës artificiale, idetë e reja dhe vizioni për të ardhmen duhet të jenë pjesë e rëndësishme e Partisë Demokratike.
- Gjithashtu, Partia duhet të ketë një **Akademi Politike funksionale**, e cila do të trajnojë brezin e ri të politikanëve të djathtë.
- Të pranohen të gjithë anëtarët e Lidhjes Demokratike të gruas anëtare me të drejtë vote të barabartë si gjithë anëtarët e tjerë të Partisë.

Duke ringritur Partinë Demokratike dhe të djathtën shqiptare, ne do të arrijmë të krijojmë besimin e duhur te qytetarët shqiptarë dhe **me votë do të rikthehemi shumë shpejt** në forcë qeverisëse. Ndryshimi fillon nga shtëpia jonë.

Ne do të vijmë në pushtet me një program qeverisës të denjë për të djathtën, shtyllat kryesore të të cilit do jenë:

- ✓ **liria e individit,**
- ✓ **antikomunizmi dhe dëmshpërblimi i të persekutuarëve dhe pronarëve të ligjshëm,**
- ✓ **çështja kombëtare dhe interesi kombëtar,**
- ✓ **lufta kundër korrupsionit dhe fundi i tenderëve të përcaktuar,**
- ✓ **listat plotësisht të hapura për zgjedhjet e përgjithshme dhe këshilltarë vendorë,**
- ✓ **rinia shqiptare dhe punësimi i tyre,**
- ✓ **prodhimi bujqësor dhe industrial, si dhe mbrojtja e prodhimit shqiptar përballë importit,**
- ✓ **ngritja e turizmit, bujqësisë dhe energjetikës mbi baza të një konsensusi kombëtar dhe jo vetëm mbi nivele tarifore.**

Zotimi im, nëpërmjet shtyllave të paraqitura më lartë, është pikërisht ky: **Një Parti Demokratike ideologjikisht e qartë, e fortë, antikomuniste, euroatlantike, meritokratike, e kthyer në shtëpinë e të gjithë të djathtëve dhe qytetarëve të lirë.**

Pjesa I: Ndryshimet e propozuara statutore dhe organizative

Partia Demokratike duhet të ketë një Statut të ri të diskutuar me anëtarësinë në çdo detaj dhe të miratuar nga anëtarësia e Partisë Demokratike. Ndryshimet Statutore të Partisë Demokratike, të cilat më tej do të diskutohen në të gjithë forumet e Partisë, gjykoj të jenë:

1. Ndryshime që mundësojnë demokratizimin, bashkimin dhe ringritjen e Partisë mbi baza të forta institucionale. Statuti i Partisë, pra Kushtetuta e saj, bëhet dokumenti më i rëndësishëm i kësaj force politike dhe askush nuk mund të dalë para ligjit (*pra Statutit të Partisë*) dhe çdo vendimmarrje merret në përputhje me këtë Statut. Shkelja e Statutit nga përfaqësuesit politikë të çdo niveli në Parti, dhe/apo nga çdo anëtar i saj ka penalitete që parashikohen në ndryshime statutore.

2. Ndryshime që të garantojnë barazinë para ligjit, sepse , si një Parti e djathtë, barazia para ligjit është në themel të parimeve të Partisë. Ndryshimet Statutore të propozuara janë një gur themel për ringritjen, bashkimin dhe mirëfunksionimin e Partisë.

2/1 Ndryshime të bazuara në liberalizmin klasik, por mund të shërbejnë edhe si një pikënisje e mirë për demokratizimin e të gjithë partive politike në vend, pasi risia e tyre është demokracia e brendshme, zbatimi me rreptësi i Statutit dhe liria e çdo anëtari.

3. Ndryshime të mbështetura në shembujt më të mirë të CDU-së Gjermane, Konservatorëve Anglezë, Republikanëve Amerikanë si dhe Statutin e Partisë Demokratike të vitit 2005 dhe 2009. Ndryshime që krijojnë një sistem "*Checks and Balance*" në Parti, duke i dhënë fuqinë e duhur çdo forumi të Partisë. Ndryshime që garantojnë se baza e të gjithë veprimit politik në Partinë mbetet **liria dhe vota e lirë dhe e pacënuar e çdo anëtari**. Çdo Anëtar i Partisë Demokratike pavarësisht funksionit që mban në Parti është një anëtar me të drejta të barabarta i Partisë dhe vota e saj/e tij është e barabartë.

4. Ndryshime në aspektin e përgjithshëm të cilat synojnë t'a kthejnë Partinë Demokratike në institucionin politik më demokratik në vend, duke bërë ndarjen e pushteteve brenda strukturës partiake.

4/1. Ndryshime që do mundësojnë ngritjen dhe funksionimin e një Struktura të re. Strukturë, e cila do organizohet në tre pushtete funksionale, që ndihmojnë njëri tjetrin. Ata janë:

a) Pushteti legjislativ, i përbërë nga dy dhoma Kuvendin Kombëtar dhe Këshillin Kombëtar të zgjedhura me votim të fshehtë nga anëtarët e Partisë;

b) Pushteti ekzekutiv, i përbërë nga Kryesia e Partisë;

c) Organet e pavarura, që mbikëqyrin veprimtarinë e Partisë në përputhje me Statutin e saj, me Kushtetutën dhe ligjet e vendit. Këto organe duhet të kthehen në funksionale duke përfshirë këtu edhe Komisionin e Apelit në Parti.

d). Të tre pushtetet të zgjidhen nga anëtarët me votë të fshehtë dhe me konkurrence të plotë, duke u bazuar në parimin bazë të së djathtës "meritokracinë" dhe qarkullimin e elitave brenda strukturave të Partisë.

e).Kuvendi Kombëtar dhe Këshilli Kombëtar propozohen të kenë nën drejtimin e tyre një Kryetar funksional dhe në pavarësi nga funksionet e Kryetarit të Partisë, të propozuar dhe të zgjedhur me votat e anëtarëve të secilit institucion, pozicione këto që krijojnë edhe pavarësinë e pushteteve brenda partisë dhe në procesin e vendimmarrjes.

5. Organi më i lartë politik i Partisë Demokratike sugjerohet të jetë Këshilli Kombëtar, i cili do të ketë, një Kryetar dhe dy Nënkryetarë, njëri prej të cilëve të jetë propozim i Forumit Rinor të Partisë Demokratike dhe një nënkryetar nga Lidhja Demokratike e Gruas.

6. Ndryshime statutore që garantojnë vendimmarrjen përsa i përket strukturave të Partisë Demokratike, listës së kandidatëve në nivel lokal dhe nivel qendror si dhe kandidaturave për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare; të gjitha të nisura nga baza e Partisë. Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nëpërmjet sistemit të primarëve, i cili do të mundësojë paraqitjen dhe përballjen e platformave politike përpara anëtarësisë. Votimi në strukturën e Degës, të bëhet nga anëtarësia e Degës. Zgjedhjet në degë do të jenë atribut i degës dhe jo i selisë Qëndrore të Partisë dhe as Kryetarit të saj, dhe do të sigurojnë decentralizimin në Parti. Përzgjedhja në strukturën e lartë, e cila përfshin kandidatët për deputetë, kandidatët për Kryetarë Bashkie dhe Kryetar Partie do të jetë sipas shembullit dhe praktikave më të mira të të gjithë partive të djathta perëndimore.

7. Ndryshime të cilat të mundësojnë që çdo vendim politik, strategji politike apo vendimmarrje për interesa të Partisë dhe të vendit të merret vetëm nga Këshilli Kombëtar i Partisë Demokratike; Këshilli, i cili do të mblidhet jo më pak se katër herë në vit.

7/1. Këshilli Kombëtar do të ketë 120 anëtarë, ku 90 prej tyre do të jenë të zgjedhur me propozime të drejtpërdrejta dhe votim të fshehtë nga Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike.

7/2. Kryesia e Partisë Demokratike do të jetë organi ekzekutiv i PD-së ku në përbërje të tij do të ketë 25 anëtarë dhe 15 prej tyre do të zgjidhen me votim të fshehtë nga Këshilli Kombëtar i PD-së.

Kryesia e partisë do të ketë në përbërjen e saj të paktën katër anëtarë kryetarë të degëve vendore të Partisë Demokratike, Përfaqësues të Forumit Rinor dhe Lidhjes Demokratike të Gruas.

7/3. Kryetari i Partisë Demokratike është përfaqësuesi politik i Partisë Demokratike dhe ai/ajo do të zgjidhet me sistemin e Primareve, me ballafaqim idesh dhe debate publike. Nuk do të ketë skualifikime kandidatësh mbi baza interpretimesh politike pasi partia jonë është parti e individëve të lirë. Kryetari i Partisë do të ketë vetëm dy mandate dhe në rast të humbjes së një palë zgjedhjeve parlamentare duhet të japë dorëheqje të parevokueshme. Kryetari i Këshillit Kombëtar merr kompetencat e Kryetarit në detyrë në rast të mungesës së Kryetarit/Kryetares.

7/4. Bordi Financiar i Partisë do jetë gjithashtu një organi i pavarur i Partisë, i cili do të zgjidhet me votim të fshehtë nga Kuvendi Kombëtar i Partisë dhe do të auditojë/inspektojë gjithë financat e partisë në çdo nivel dhe do të raportojë pranë Kuvendit Kombëtar.

Pjesa II: Shtyllat ideologjike dhe programore të Partisë Demokratike

- **Shtresa e mesme, të shkolluarit, rinia dhe diaspora, si pjesë e pandashme e Partisë Demokratike**

Një nga faktorët që forcojnë në mënyrë të padiskutueshme një komb është rritja e numrit të njerëzve me aftësi për të punuar, të shkolluar mirë dhe që japin kontribut në fusha të ndryshme. Vitet e fundit janë shoqëruar me një braktisje të detyruar të Shqipërisë nga ajo pjesë e popullsisë që ka aftësi të kontribuojë më shumë për vendin, e cila në përgjithësi quhet shtresa e mesme. Në Shqipëri kjo shtresë e popullsisë është në pjesën më të madhe e shpërbërë ose e larguar, falë politikave shkatërruese të qeverisë dhe humbjes së shpresës nga paaftësia e udhëheqjes aktuale të Partisë Demokratike.

Ndërtimi i një klase të mesme, i investimit për rikthimin e profesionistëve dhe prodhuesve, arsimimit të duhur dhe përfshirjes në ekonomi të të gjithë atyre që mund të kontribuojnë është me rëndësi primare. Partia Demokratike është krijuar **si parti e rinisë dhe intelektualëve** dhe dera e saj duhet të jetë përherë e hapur ndaj tyre. Për të ndërtuar një Shqipëri më të mirë, nevojitet një Parti Demokratike ku të dëgjohet **zëri i profesionistëve dhe prodhuesve** të këtij vendi, **sipërmarrësve, intelektualëve, njerëzve të penës e mendjes** dhe interesat e këtyre grupimeve të merren parasysh.

Rinia shqiptare, duke pasur në krah Partinë Demokratike me politikat e duhura mbështetëse do të ketë mundësinë të çlirojë të tërë potencialin e vetë, dhe do të mundet të shohë të ardhmen në vendin e vet. Akademia Politike dhe një rol më i madh i Forumit Rinor do të mundësojnë që zëri, problematikat dhe interesat e të rinjve të dëgjohen dhe të adresohen.

Gjithashtu, Partia Demokratike **do të jetë plotësisht e hapur ndaj Diasporës**, e cila do të ketë përfaqësuesin e vetë në Këshillin Kombëtar të Partisë. Një Parti Demokratike e hapur dhe transparente, e forcuar dhe me qëndrime të qarta mbi çështjet dhe interesat e mëdha kombëtare do t'i hapë **rrugë më në fund një bashkëpunimi të Republikës së Shqipërisë me të gjithë faktorin shqiptar në Ballkan, si dhe me Diasporën Shqiptare, për të mbrojtur pa asnjë mëdyshje interesin e shqiptarëve.**

▪ **Të përndjekurit politikë dhe pronarët e ligjshëm, si shtyllat bazë të Partisë Demokratike dhe antikomunizmi si parim themelor**

Sot, ka një distancim të udhëheqjes aktuale të Partisë ndaj ish të përndjekurve. Shpesh, Partia Demokratike e ka marrë për të mirëqenë mbështetjen e kësaj shtrese e herë të tjera i ka shpërfillur krejtësisht. Një ndjesë e Partisë më të madhe të djathtë në Shqipëri do të vijë me zotimin për t'i rikthyer ish të përndjekurit dhe të persekutuarit e regjimit komunist në vendin që u takon. Partia Demokratike dhe unë në krye të saj do të bëjmë propozimet e duhura, duke nisur që gjatë periudhës në të cilën do të jemi në opozitë. *Në rast se përgjatë viteve në vijim, këto propozime për dëmshpërblimin e këtyre individëve nuk do të merren parasysh nga qeveria aktuale*, Partia Demokratike nën drejtimin tim do të krijojë mekanizmat e nevojshëm dhe do të zbatojë një program specifik dhe të detajuar për dëmshpërblimin e atyre që kanë vuajtur përgjatë regjimit diktatorial, **që në mandatin e parë qeverisë.** Partia Demokratike do të jetë përherë mbrojtësja më e fortë e atyre që kanë vuajtur dhe kanë sakrifikuar për shkak të fjalës së lirë, mendimit ndryshe dhe përkatësisë politike. Të përndjekurit politikë do të mund të rikthehen më në fund në shtëpinë e tyre politike; zëri dhe historia e tyre më në fund do të mund të dëgjohen dhe drejtësia e tyre mirëfilli do të vihet në vend.

- Partia Demokratike do të kryejë në radhë të parë një **ndjesë ndaj të gjithë të persekutuarëve** të regjimit komunist, pasi për këtë shtresë fisnike të shoqërisë, drejtësia nuk u vu plotësisht në vend.
- Nën drejtimin tim, në Partinë Demokratike **do të marrë fund përgjithmonë, strehimi, mbrojtja dhe promovimi i individëve që kanë qenë pjesë e ish-sigurimit të shtetit, nomenklaturës së partisë-shtet dhe mendësisë komuniste.** Partia jonë, parti e shpresës dhe lirisë nuk mund të jetë më peng i shtypësve dhe dhunuesve, i atyre që kanë kryer krime të paimagjinueshme dhe i kontribuesve në instalimin dhe vazhdimësinë e regjimit më gjakatar në Evropë.
- Cilido që do të kërkojë të hyjë në Partinë Demokratike apo do të synojë poste drejtuese në këtë parti, **do të ketë publike dosjen e sigurimit të shtetit** në mënyrë që të hiqet çdo dyshim mbi pastërtinë e figurës.
- Unë zotohem që Partia Demokratike do të fillojë **një proces të dënimit të krimeve të komunizmit** dhe një **ligj të memories historike** për t'u ndarë përgjithmonë nga ai kapitull i errët i historisë sonë, dhe për të filluar më në fund një proces të vonuar shërimi dhe bashkimi të popullit shqiptar.

Partia Demokratike do të jetë **grupimi politik i njerëzve të pastër moralisht** që kanë të drejtën etike për të dalë në mbrojtje të të persekutuarëve politikë dhe i çdo individi që e gjen veten në antitezë me komunizmin.

Nga ana tjetër, **e drejta e pronës** konsiderohet nga shoqëritë perëndimore, dhe nga traditat e zakonet shekullore të kombit shqiptar **si një e drejtë që lind me njeriun, e pandryshueshme nga ligjet apo ndërhyrja qeveritare.**

Një e drejtë e patjetërsueshme si ajo e pronës nuk mund të frenohet ose shfuqizohet nga ligjet njerëzore dhe rrjedh nga natyra jonë si njerëz të lirë. Regjimi komunist, ashtu siç veptoi me shumëçka në vendin tonë, sulmoi dhe përçudnoi këtë të drejtë natyrale të njeriut. Pas vitit 1990, misioni fisnik i dënimit të këtij krimi dhe kompensimit të viktimave iu ngarkua Partisë Demokratike, e cila nuk mundi t'i shkante deri në fund, për t'i dhënë drejtësinë e merituar pronarëve të ligjshëm.

E drejta e pronës është një ndër kolonat që qëndrojnë në themel të çdo force të djathtë në Perëndim. Për realitetin shqiptar, duke konsideruar padrejtësinë e bërë për pesë dekada ndaj një numri të konsiderueshëm qytetarësh nga regjimi i kohës, ky parim merr një rëndësi të veçantë. Partia Demokratike nuk mund të anashkalojë më, dhe as të harrojë një grupim shoqëror që përbën bazën e të djathtës, dhe që i ka qëndruar pranë Partisë Demokratike pa kërkuar gjë në këmbim.

Partia Demokratike dhe unë, nëpërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe çdo mekanizmi tjetër, do të fillojmë procesin e nevojshëm ligjor dhe moral për të rikthyer ose kompensuar pronën te i zoti i ligjshëm, duke korrigjuar kështu një ndër krimet më të mëdha të regjimit komunist.

- **Me ardhjen në pushtet të Partisë Demokratike, pronat, të cilat janë të lira** – dhe në çdo rast tjetër në të cilin do të jetë e mundur – **do të kthehen të pronari të ligjshëm.**
- Në rastet kur prona është e zënë dhe rikthimi te pronari të ligjshëm nuk është i mundur, Partia Demokratike do të fillojë **një proces kombëtar për kompensimin e kësaj prone**, sipas praktikave më të mira botërore. Është një zotim i imi dhe do të duhet të jetë dhe i Partisë Demokratike që drejtësia për pronarët e ligjshëm të vihet në vend.
- Mbetet i nevojshëm një konsultim i plotë dhe i vazhdueshëm deri në fund me pronarët e ligjshëm për zgjidhjen e çështjes së pronave dhe në mënyre specifike të tokës bujqësore.

Partia Demokratike lindi si antitezë e një realiteti jo-natyrar, dhe nuk mund të kthehet në një kopje të shëmtuar të tij. Na takon ne të japim shembullin perëndimor brenda Partisë që më pas ta zbatojmë në qeverisje. Që të sjellim demokracinë në vend, duhet ta nisim nga shtëpia jonë. **Fjala e lirë, kritika, mendimi ndryshe duhet të jenë të lidhura pazgjidhshmërisht me atë çka Partia Demokratike është.** Shtresa e të persekutuarëve politikë është aty për të na kujtuar pikërisht këtë. Në Partinë tonë nuk duhet të ketë zot veç Zotit, nuk duhet të ketë sundues tjetër përveç fjalës dhe arsyes dhe nuk duhet të ketë yll tjetër polar veç parimeve të meritokracisë, konkurrencës dhe idealeve të vitit 1990.

- **Patriotizmi, çështja kombëtare dhe përkatësia euroatlantike**

Partia Demokratike duhet të jetë një forcë patriotike. Çështja kombëtare, mbrojtja e interesave të kombit shqiptar dhe shqiptarëve kudo që janë, duhet të jenë faktorë vendimtarë në veprimtarinë e Partisë.

Filozofi konservator Roger Scruton shkruan se themeli i demokracisë rrjedh nga një ndjenjë e besnikërisë kombëtare. Koncepti i përgjegjësisë në një demokraci është thelbësor, dhe ai rritet në mënyrë të drejtpërdrejtë me forcimin e patriotizmit. Nga ana tjetër, solidariteti kombëtar është baza e besnikërisë reciproke të qytetarëve. **Patriotizmi është garantues i të drejtave të individëve**, të cilat përfshijnë lirinë e fesë, mendimit dhe fjalës. Sipas Scruton, besnikëria kombëtare është shkëmbi mbi të cilin bazohen të gjitha liritë themelore të njeriut.

Vetëm kur individit i zgjohet dhe i forcohet dashuria për vendin, kur ka lidhje të qëndrueshme me komunitetin ku është lindur dhe rritur, atëherë ai kërkon më tepër për veten, familjen dhe kombin. Në këtë mënyrë rritet kërkesa e llogaridhënies së qytetarit ndaj qeveritarëve. Partia Demokratike duhet të synojë me anë të politikave të saj:

- një arsimim më të mirë e patriotik,
- një ambientalizëm konservator për të ruajtur trashëgiminë kulturore e artistike,

- për të rikthyer fillin e memories historike dhe trashëgiminë e brezave të kaluar, të dëmtuara nga regjimi komunist dhe tranzicioni tridhjetëvjeçar.

Një rizgjim i patriotizmit rrit dëshirën dhe kërkesën e individëve dhe, veçanërisht të funksionarëve shtetërorë për institucione të forta e të qëndrueshme, të cilat i bëjnë ballë presioneve të ndryshme, si të faktorëve të jashtëm, ashtu dhe aktorëve të brendshëm që veprojnë për interesa personale.

Patriotizmi bën që Partia Demokratike të ketë në fokusin e saj familjen shqiptare dhe forcimin e saj, duke ndaluar ikjen masive dhe shpopullimin që po i bëhet Shqipërisë. Duke pasur një Parti Demokratike të fortë dhe të vërtetë në luftën e saj me krimin, korrupsionin dhe iniciuesit e procesit të shpopullimit të vendit, shpresa dhe besimi i njerëzve – dhe sidomos i rinisë – rindizet dhe familjet shqiptare kanë një arsye më shumë për të qëndruar, për të luftuar për vendin e tyre dhe për ndërtuar jetën e tyre në Shqipëri. Sado e keqe të jetë një qeveri, shpresa humbet kur opozita i largohet misionit të vet dhe kthehet në një mbështetëse të regjimit. Ndryshimi fillon nga reformimi i Partisë Demokratike.

Patriotizmi do të bëjë anëtarët dhe udhëheqjen e re të Partisë Demokratike që të ringrejnjë institucionet brenda Partisë, në mënyrë që të japim shembullin e demokracisë dhe institucionalizimit. Një statut i ri, me rregulla të drejta dhe të udhëhequr nga motive patriotike, do të bëjë të mundur forcimin e Partisë, dhe do e kthejë atë në grupimin më përfaqësues të shqiptarëve. Është ky **patriotizëm dhe rikthim në institucionalizim dhe demokraci të brendshme** që do t'i hapë rrugë primareve dhe fraksioneve në parti, që do të bëjë të mundur debatin e brendshëm dhe konkurrencën e ideve.

Kjo hapje në emër të patriotizmit do sjellë forcimin e mëtejshëm të Partisë Demokratike dhe **një PD e fortë do të mund të jetë një faktor vendimtar në mbrojtjen e Kosovës, të Çështjes çame, të shqiptarëve në komunitet e Preshevës, Bujanovcit, Medvegjës, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të Malit të Zi dhe kudo ku jetojnë shqiptarë.**

Gjithashtu, duke vendosur kombin, individin dhe familjet shqiptare përpara interesave personale të individëve specifikë, Partia Demokratike do të mundë të rikthejë shpresën, dhe do të jetë e aftë që të kryejë një betejë pa kompromise me korrupsionin, krimin dhe gjithashtu me manipuluesit zgjedhorë. Duke krijuar një frymë reale ndryshimi nëpërmjet bashkimit patriotik, ekonomik dhe kulturor të të gjithë faktorëve të qendrës së djathtë dhe të së djathtës në vend.

Pa dyshim, një Parti Demokratike e pozicionuar qartë nga ana patriotike dhe ideologjike, e ringritur nga ana strukturore dhe e pastër nga ana morale, **do të forcojë mandej dhe lidhjet e ngushta e të vazhdueshme me partnerin strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Bashkimin Evropian.**

Partia Demokratike është një parti euroatlantike. Historia e Partisë përfshin futjen e Shqipërisë në Këshillin e Evropës, marrëveshjen e stabilizim – asocimit, heqjen e vizave me Bashkimin Evropian, futjen e Shqipërisë në NATO, pritjen që iu bë në vizitën e parë dhe të vetme të një presidenti amerikan në Shqipëri, George W. Bush dhe një sërë bashkëpunimesh si me SHBA dhe me BE. **Bashkëpunimi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian në interes të shqiptarëve do të jetë me prioritet të padiskutueshëm në Partinë Demokratike.**

Ringritja e së djathtës shqiptare nëpërmjet fuqizimit të Partisë Demokratike kalon domosdoshmërisht nga çështja kombëtare, patriotizmi dhe forcimi i bashkëpunimit me Perëndimin.

Duhet të jemi patriotë shqiptarë për të qëndruar kokë-lartë mes patriotëve të tjerë Evropianë.

▪ **Lufta pa kompromis ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar**

Partia Demokratike ka treguar, veçanërisht në periudhën e qeverisjes së vendit 2005 – 2009, se është e aftë të dalë në krye të luftës kundër korrupsionit dhe krimit dhe të jetë e suksesshme. **PD-ja ka qenë dhe duhet të jetë partia e ligjit dhe rendit.**

Në vitin 2005, Shqipëria ishte kthyer në një sinonim të krimit të organizuar. Trafikantët shqiptarë të njerëzve, armëve dhe gjendeshin në titujt e gazetave dhe lajmeve të kryeqyteteve perëndimore.

Sipas raporteve të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, niveli i korrupsionit në Shqipëri ishte rritur me 300% që nga viti 1997. Ky korrupsion përkrahur si "endemik", i kushtoi vendit rreth 990 milion € në të ardhura të humbura, përgjatë tetë viteve të qeverisjes socialiste 1997-2005. Zyrtarët ndërkombëtarë të policisë vlerësonin se vlera e drogës që kalonte nëpër Shqipëri çdo vit ishte rreth 2 miliardë euro.

Por, Partia Demokratike arriti të krijonte një frymë ndryshimi dhe shprese të shumica e popullsisë së vendit dhe bashkoi mjaftueshëm njerëz sa të tejkalonte ndikimin e ndërhyrjeve shtetërore, blerjes së votave dhe kërcënimeve të grupeve kriminale dhe të vinte në pushtet. Përgjatë mandatit të parë qeverisës, u krye një luftë serioze dhe me rezultate kundër grupeve kriminale dhe korrupsionit në vend. U dënuan bandat kriminale, duke rikthyer rendin dhe qetësinë në vend.

Në vitin 2009, progres raporti i Komisionit Evropian shkruante se *“qeveria ka bërë përpjekje të koordinuara për të luftuar korrupsionin në disa fusha. Aty ku korrupsioni mund të rezultojë nga kontakti i drejtpërdrejtë midis sektorit privat dhe administratës, u morën masa që synonin zvogëlimin e kontakteve personale me zyrtarët. Masat përfshijnë zvogëlimin e burokracisë dhe reformën e procedurave. Ishte një Strategji Ndërsektoriale për Parandalimin dhe Luftimin e Korrupsionit 2008-2013, miratuar në tetor 2008, pasuar nga miratimi i një plani veprimi në janar 2009, implementimi i të cilës ka filluar. Vërehet përparim në lidhje me përmirësimin e legjislacionit në përputhje me Konventën Civile të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit.”* Pra, historia tregon se vullneti politik dhe një vizion i qartë antikorrupsion dhe antikrim mjafton për të dhënë rezultate. Sot na duhet të ndërtojmë mbi këtë histori të Partisë Demokratike dhe ta çojmë më tej vendosmërinë tonë për këto beteja.

Vendi sot gjendet përpara një situatë të ngjashme me vitin 2004-2005. Progres raporti i vitit 2020 theksonte se, *në përgjithësi, korrupsioni mbetet i përhapur dhe është një shqetësim serioz.* Raporte të ndryshme ndërkombëtare, duke përfshirë dhe raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit, flasin për një kapje të shtetit (*state capture*) Zgjedhjet manipulohen rregullisht nga qeveria – dhe në zgjedhjet e fundit problemet i theksoi dhe raporti paraprak i OSBE/ODIHR – *por opozita ka qenë e paaftë për të krijuar frymën e nevojshme për të sjellë një pjesëmarrje masive në zgjedhje që të neutralizojë efektin e krimit dhe korrupsionit shtetëror.*

Me gjithë historinë e suksesshme të Partisë Demokratike në luftën kundër krimit dhe korrupsionit, udhëheqja aktuale e Partisë nuk i vendosi këto dy probleme madhore në qendër të fushatës së fundit. **Partia Demokratike ka nevojë për një pastrim moral brenda vetes së vet, dhe një përfaqësim dinjitoz pa lidhje me afera korruptive apo skandale.** Në këtë mënyrë, bëhet i mundur bashkëpunimi me qytetarët dhe krijohet besimi se Partia jonë është serioze dhe e vendosur në këtë betejë. Pa krijuar besim të shumica e individëve, se Opozita shqiptare drejtohet nga njerëz pa asnjë lidhje me afera të dyshimta korruptive, fryma e ndryshimit do të jetë e pamundur të arrihet.

Partia Demokratike do të ketë procese që do të sigurojnë filtrimin e të gjithë personaliteteve, të cilat do të jenë në poste drejtuese apo vendimmarrëse. Këto procese do të jenë transparente dhe pjesë e garës së primarëve në parti.

Pas krijimit të një udhëheqje të pastër moralisht, **betëja jonë do të zhvillohet në Parlament me propozime serioze legjislative, dhe me një denoncim aktiv me dosje të faktuara ndaj çdo përpjekje korruptive apo kriminale, pa asnjë kompromis të çdo kancelari evropian.**

Sensibilizimi i opinionit publik dhe ndërkombëtar, me anë të faktimit të rasteve korruptive, **bashkëpunimit me parti aleate në Bashkimin Evropian dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës,** dhe fitimi në radhë të parë i **besimit të shumicës së vendit, se Partia Demokratike këtë luftë e ka seriozisht** do të jenë në themel të opozitarizmit tonë. Mandej, në pushtet, Partia Demokratike nën drejtimin tim zotohet të ketë përkushtimin maksimal ndaj kësaj lufte.

Zbatimi i politikave dhe strategjive kundër korrupsionit, forcim i legjislacionit ndaj korrupsionit në administratë dhe jo vetëm, rritja e kapaciteteve e agjencive që luftojnë korrupsionin dhe institucioneve kundër krimit të organizuar, pavarësia e policisë së shtetit, krijimi i mekanizmave të nevojshme për luftën ndaj korrupsionit, forcimi i të ashtuquajturave *checks and balances* dhe rritja e ndëshkueshmërisë duhet dhe do të jenë në thelb të programit tonë politik.

Ndryshimi duhet të fillojë në shtëpinë tonë politike. Nëse do të kemi vullnetin të shohim brenda nesh, të reflektojmë dhe të ringrihem me anë të kartës morale, atëherë mund të kërkojmë besimin e popullit shqiptar për të dalë në ballë të betejës kundër korrupsionit, përdorimit të administratës shtetërore për qëllime politike, krimit të organizuar dhe lidhjeve të tij me politikën.

- **Ekonomia e tregut dhe vendosja e kapitalizmit në vend**

Shqipëria në tridhjetë vitet e tranzicionit nuk ka mundur të vendosë një ekonomi tregu apo një sistem kapitalist të vërtetë. Një sërë faktorësh, si historik, ashtu dhe politik e kulturor, kanë bërë të pamundur përparimin e një sistemi që do të mundësonte më shumë rritje ekonomike, zhvillim dhe begati në vend.

Megjithatë, duke konsideruar të gjithë pengesat, qeverisja e kaluar e Partisë Demokratike mund të thuhet me siguri, se ka qenë me e suksesshme në zbatimin e një programi të qendrës së djathtë, sidomos në vitet 2005 – 2009, pa harruar dhe reformat fillestare të fillim-viteve nëntëdhjetë, që shënjuan hapat e parë të tranzicionit në Shqipëri.

Përgjatë fushatës së fundit, Partia Demokratike pati një program ekonomik përgjithësisht të qendrës, ku mbizotëronin elementet e asistencializmit. Por, siç do të shprehej Presidenti Ronald Reagan, programi më i mirë i asistencës është një vend pune. Premtimi i djathtë më i spikatur ishte ai i vendosjes së një takse progresive të ulët me dy shkallë, 0% për individët me të ardhura deri në 30,000 lekë, dhe 9% për individët me të ardhura mbi 30,000 lekë.

Partia Demokratike, si pjesë e procesit të kthjellimit ideologjik të saj, **duhet të rikthehet te promovimi dhe zbatimi i një Ekonomie të Tregut,** i cili vendos në qendër individin dhe potencialin e tij, **meritokracinë, konkurrencën e ndershme dhe prodhimin.** Është individi ai që ka aftësitë e nevojshme për të prodhuar, për të ofruar shërbime, për të rritur ekonominë e një vendi. Duke vendosur **taksa të ulëta,** duke **ulur në mënyrë drastike shpenzimet qeveritare të panevojshme,** duke **luftuar kundër kapitalizmit klientelist** të promovuar nga qeveria aktuale, duke **reduktuar burokracinë** dhe duke dhënë shtysat e

nevojshme që **Shqipëria të kthehet në një vend prodhues**, Partia Demokratike do të mundësojë rritjen ekonomike të nevojshme për t'u përkthyer në prosperitet për qytetarët. Historia jonë, por dhe e vendeve të tjera perëndimore ka treguar se, sa herë qeveritë kanë zvogëluar ndërhyrjet e panevojshme në ekonomi dhe kanë zbatuar politika kapitaliste të ekonomisë së tregut, rritja ekonomike ka qenë e konsiderueshme dhe e qëndrueshme. Nxitësi më i madh i begatisë në një vend janë individët dhe kompanitë që kërkojnë fitim, të cilat operojnë brenda një ekonomie tregu konkurruese, të drejtuar nga ligji dhe të mbikëqyrur nga një gjyqësor i ndershëm. Sa më konkurruese të jenë kompanitë dhe sa më produktive të jenë ato, aq më të larta do të jenë pagat e individëve që punojnë në to. Nuk është qeveria ajo që rrit pagën minimale, por sektori privat.

Partia Demokratike si një forcë e djathtë duhet të sigurojë **barazinë e mundësive**, ku të promovohen më të merituarit, duke vendosur kështu **një sistem meritokratik**, nëpërmjet konkurrencës së njerëzve. Kjo do të fillojë nga vetë Partia, ku meritokracia do të jetë në qendër të çdo promovimi.

Gjithashtu, si pjesë e pandashme dhe jetike e një shoqërie të drejtë dhe meritokratike, do të kemi një fokus serioz në arsim, për të krijuar një brez të ri patriot dhe me aftësitë e duhura për sfidat e shekullit të 21-të. Natyrisht, ekonomia e tregut, edukimi dhe demokracia janë të lidhura ngushtë, sepse një ekonomi e tregut të lirë kërkon një popullsi më të arsimuar dhe kjo e fundit, nga ana tjetër, kërkon pjesëmarrje në politikë dhe vendimmarrje.

Nën drejtimin tim, **politikat që përfshijnë përmirësimin e arsimit, aftësive dhe trajnimit, stimujt për individë dhe kompani, përmirësime të infrastrukturës, reformat në prodhimtari, bujqësi e industri do të jenë në themel të çdo programi ekonomik**. Unë besoj se të gjithë qytetarët shqiptarë kanë aftësinë të kenë sukses në vendin e tyre, kur u sigurohen rregulla të drejta. Unë, ashtu si çdo person i djathtë në Partinë Demokratike mendoj, se është individi shqiptar dhe jo politikanët apo qeveritarët, ai që prodhon, investon dhe e çon vendin përpara. Partia Demokratike do të jetë në krah të secilit individ, duke mbrojtur liritë e tij ekonomike, së bashku me ato të fjalës, mendimit dhe të gjithë te drejtave natyrale të njeriut.

- **Ringrihemi së bashku për të shpëtuar Shqipërinë – Për një PD dhe të djathtë antikomuniste, euro-atlantike, patriotike e demokratike.**

Partia Demokratike është **grupimi i shqiptarëve të ndershëm, i punëtorëve, i sipërmarrësve, i të përndjekurve politikë, i pronarëve të ligjshëm, i atyre që duan meritokracisë, traditën, historinë, çështjen kombëtare, rendin, ligjin, sigurinë kombëtare, lirinë e mendimit e të fjalës, të lëvizjes së lirë e të ekonomisë së tregut**. Partia Demokratike është **streha e njerëzve të lirë, patriotë dhe që përqafojnë vlerat euroatlantike**, bashkëpunimin me **Shtetet e Bashkuara të Amerikës e Bashkimit Evropian**.

PD-ja ka potencialin e jashtëzakonshëm që të mbledhë individët që e gjejnë veten në qendrën e djathtë dhe djathtas, monarkistë dhe ballistë, tradicionalistë, libertarianë dhe konservatorë. Të gjithë ata që janë kundër korrupsionit qeveritar dhe bandave kriminale mund ta quajnë veten pjesë të Partisë Demokratike. Kushdo që refuzon komunizmin dhe socializmin, censurën dhe kultin e individit, mund të shohë te Partia Demokratike shtëpinë e vet politike.

Së bashku, mund të garantojmë që në Partinë tonë të mbizotërojë meritokracia, gara e ndershme, shkëmbimi i ideve, duke:

- vendosur disa rregulla statutores të qarta e të gjithëpranuara;
- krijuar një Parti qartësisht të djathtë;
- sanksionuar primarët brenda Partisë sipas shembujve më të mirë perëndimorë;
- hapur dyert e Partisë për këdo të djathtë, moralisht të pastër që dëshiron të kontribuojë;
- forcuar bazën dhe strukturat e Partisë në çdo qytet, fshat apo zonë të Shqipërisë, për të qenë në çdo moment sa më pranë qytetarit dhe problemeve të tij, pavarësisht se është apo jo periudhë fushate zgjedhore.

Ky riformatim dhe riorganizim i Partisë Demokratike përbën të vetmen mënyrë që vendi të ketë një vlerë të shtuar, dhe një qeverisje të mirë. Duke dhënë shembullin e lirisë, demokracisë dhe meritokracisë brenda Partisë, ne japim garancitë për një qeverisje dinjitoze perëndimore. Duke dënuar krimet e komunizmit dhe duke kompensuar ata që kanë përjetuar vuajtjet e tmerrshme nga regjimi, ne shkëputemi nga hijet e së kaluarës dhe hedhim vështrimin drejt së ardhmes.

Së bashku ne mund të rikthejmë Partinë Demokratike te vlerat dhe parimet, te besimi dhe shpresa e qindra mijëra shqiptarëve në vitin 1990. Me ato vlera dhe ide të pastra dhe të pa kompromentuara, me eksperiencën e tridhjetë viteve dhe me vizionin e duhur ne mund të krijojmë një Shqipëri moderne, të begatë dhe demokratike.